

VENDIM
Nr. 207, datë 9.9.2025

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “AMEL ENERGY” SHPK NË VEPRIMTARINË
E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME
KAPACITET PRODHUES 2 mw**

(Ndryshuar me vendimin nr. 135, datë 21.5.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a”, 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.9.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2174/9 prot., datë 3.9.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Amel Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Amel Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2174 prot., datë 28.7.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 182, datë 7.8.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 8.8.2025 dhe 9.8.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 18.8.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua në dy gazeta zyrtare, në faqen zyrtare të internetit të ERE-s dhe në rrjetet sociale të institucionit.

- Me shkresën nr. 2174/3 prot., datë 11.8.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar depozitimin e informacionit/dokumentacionit të aplikimit të konstatuar të paplotësuar ose të plotësuar pjesërisht.

- ERE, gjithashtu, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 2174/4 prot., datë 11.8.2025, ku po ashtu i ka kërkuar të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe, në lidhje me vlefshmërinë e kontratës dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur kthim përgjigjeje.

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 2174/5 prot., datë 22.8.2025 dhe 2174/6 prot., datë 27.8.2025, shoqëria ka depozituar informacion dhe dokumentacion plotësues, nga shqyrtimi i të cilit është vlerësuar se shoqëria duhet të japë informacion shtesë, në lidhje me vlerën e investimit, ndaj ERE iu drejtua asaj me *email*-in e datës 2.9.2025, protokolluar me nr. 2174/7 prot., datë 2.9.2025.

- Me *email*-in e datës 2.9.2025, protokolluar në ERE me nr. 2174/8 prot., shoqëria ka paraqitur sqarimet përkatëse.

- Sipas analizimit të këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera:

- Shoqëria ka nënshkruar me MIE-n kontratën nr. 2428 rep., nr. 1573 kol., datë 28.4.2023, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria ‘Amel Energy’ sh.p.k.”.

- Me shkresën e “OSSH” sh.a., nr. 5721/3 prot., datë 28.6.2022, është miratuar pika e lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes.

- Shoqëria është pajisur me vendim për VNM paraprake, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), më 2.5.2024, për ndërtimin e impiantit fotovoltaike me fuqi 2 mw.

Kushtet dhe afatet ligjore:

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka depozituar garancinë 30-vjeçare të performancës për panelet fotovoltaike, ndaj dhe afati i licencës vlerësohet që të jetë për 30 vjet.

- Shoqëria aktualisht disponon një VNM të vlefshme deri më 2.5.2026, dhe duhet të fillojë punimet brenda këtij afati. Por nga ana tjetër ajo ka parashikuar që të vendosë në operim centralin brenda muajit dhjetor 2025, që është brenda afatit të vlefshmërisë së VNM-së përkatëse. Në këto rrethana, vlerësohet që të përcaktohet që shoqëria duhet të fillojë operimin brenda datës 31.12.2025.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 10 të kontratës së nënshkruar me MIE-n vlerësohet që shoqërisë t’i lihet kusht që me fillimin e operimit/ushtimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, por jo më vonë se 60 ditë nga ky fakt, të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për testimin e veprës.

- ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi në rast të depozitimit të dokumentacionit sa lënë detyrë shoqërisë dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Amel Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

2. Shfuqizuar.

3. Shfuqizuar.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Amel Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OSSH” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti